



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

**të mbledhjes së pestë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 29.09.2017,
e cila filloi në orën 10:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, Muhedin Nushi, nënkryetar, këshilltarët e Kuvendit: Hazir Borovci (LDK), Agim Gashi, shef i GP-së (LDK), Ismail Kasumi (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Naime Osmani (LDK), Shefki Gashi (LDK), Shaip Hajrizi (LDK), Vjollca Dibra - Ibrahimimi (LDK), Shefqet Sylejmani (LDK), Muhamet Nura (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Hasime Krasniqi (LDK), Besa Rafuna (LDK), Ajnishahe Azemi (LDK), Hetem Kupina (LDK), Merita Surkishi (LDK), Fisnik Osmani (LDK), Misim Bajrami (LVV), Sylejman Pireva (LVV), Hatixhe Hoxha (LVV), Genc Sherifi (LVV), Teuta Krasniqi (LVV), Bardha Dida - Rogova (LVV), Sadri Ramabaja (LVV), Hatixhe Latifi - Pupovci (LVV), Berat Lahu (LVV), Lirie Avdiu (PDK), Shemsi Veseli (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Laura Zherka (PDK), Egzona Podvorica (PDK), Mirlinda Sopi, shefe e GP-së (AKR), Sami Boroci (AKR), Kimet Zeqa (AKR), Rejhan Vuniqi (AKR), Imer Rusinovci (AAK-LDD), Rita Begolli (AAK-LDD), Fadil Gashi (AAK-LDD), Feti Mehdiu, përfaqësues i subjektit politik (PD), Abetare Fazliu, përfaqësuese e subjektit politik (LB), Nenad Miladinoviqi, përfaqësues i subjektit politik (GIS) dhe Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik (KDTP).

Munguan: Ylli Hoxha (LVV), Lirak Çelaj, shef i GP-së (PDK), Blerand Stavileci (PDK), Shaip Shabani (PDK), Remzi Pacolli (AKR), Brahim Mehmetaj, shef i GP-së (AAK-LDD), Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik (PF) dhe Abit Kastrati.

Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të KFOR-it dhe përfaqësues të OSBE-së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues.

Kryesuesi e ftoi znj. Rejhan Vuniqi, anëtare e AKR-së, që ta bëjë betimin para anëtarëve të Kuvendit.

Kryesuesi e hapi diskutimin rreth rendit të ditës.

Agim Gashi tha se pika e shtatë e rendit të ditës është propozuar në kundërshtim me ligjin, për shkak se dhënia e pronës në shfrytëzim afatgjatë duhet të jetë në përputhshmëri me ligjin përkatës. Në këtë rast, kërkesa e ndërmarrjes "Hortikultura" nuk ka të bëjë me rast të veçantë, andaj propozoj që kjo pikë të ndryshohet në përputhshmëri me ligjin dhe të votojmë për aq sa kemi të drejtë ligjore.

Ai njëherësh propozoi që pika e gjashtë, pika e nëntë, pika e njëmbëdhjetë dhe ndonjë pikë tjetër, të shtyhen për ndonjë seancë tjetër.

Hatixhe Hoxha kërkoi sqarim nga Zyra ligjore rreth pikës së shtatë të rendit të ditës "Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë ndërmarrjes publike komunale "Hortikultura"". Ajo tha se nëse ekziston baza, atëherë të diskutohet kjo pikë dhe të mos shtyhet më tutje. Gjithashtu, propozoi që në këtë seancë të diskutohet çështja e memorialit përkujtimor për ushtarët britanikë të KFOR-it.

Muhamet Selmani propozoi që pika e tretë, e katërt, e pestë, e shtatë, e nëntë dhe pika e njëmbëdhjetë të hiqen nga rendi i ditës.

Sami Boroci bëri të ditur se Grupi i asamblistëve të AKR-së pajtohet me propozimin që këto pika të ndahen në dy seanca, duke pas parasysh se janë shumë të rëndësishme, veçanërisht pika për buxhetin.

Ardian Olluri, në emër të ekzekutivit, propozoi që të shtohet si pikë e rendit të ditës "Dhënia e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim afatshkurtër Federatës së Tenisit të Kosovës".

Gjithashtu propozoi që pika që ka të bëjë me ndërmarrjen "Hortikultura", të hiqet nga rendi i ditës dhe të procedohet në mbledhjen e radhës.

Muhamet Selmani tha se propozimi i tij ishte që pika e tretë të shtyhet për mbledhjen e radhës ose të ndahen pikat në dy pjesë.

Feti Mehdiu u shpreh i pajtimit që pika e shtatë të hiqet nga rendi i ditës, kurse pikat tjera të diskutohen dhe seanca të ndahet në dy pjesë.

Kryesuesi ceku se është propozimi i z. Agim Gashi që pikat: 4, 6, 9, 11 dhe 7 të hiqen nga rendi i ditës dhe të shtyhen për një mbledhje tjetër.

Sa i përket pikës së shtatë, është edhe propozimi i ekzekutivit që të hiqet nga rendi i ditës dhe të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Kryesuesi konstatoi se më 26 (njëzet e gjashtë) vota për, 13 (trembëdhjetë) vota kundër (votimi është bërë me ngritje dore dhe nuk janë të regjistruar emrat e votuesve), pikat 4, 6, 9, 11 dhe 7 të rendit të ditës shtyhen për mbledhjen e radhës së Kuvendit.

Ismail Kokaj theksoi se pikën e tretë të rendit të ditës “Propozimrregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tatim në pronën e paluajtshme” e kemi shqyrtuar edhe në KPF, janë vetëm përmirësimet e gabimeve që kanë qenë më herët. Kemi disa rrugë të tjera që janë bërë gabime, mundet me qenë lokacioni që e ka ndërruar zonën, sepse nuk ka qenë në atë zonë, për atë arsye ju mundeni ta merrni si ulje të çmimit, por nuk ka as ulje, as ngritje të çmimit.

Agim Gashi kërkoi sqarim lidhur me rregulloren e mëparshme për tatimin në pronën e paluajtshme. Ai tha se kur e krahasojmë këtë pikë të rendit të ditës, ka ndryshime shumë të mëdha. Ne nuk jemi kundër ndryshimeve, por kjo sigurisht ka mundur të bëhet shumë më herët, sepse këto taksa kanë qenë shumë të larta.

Misim Bajrami tha se Rregullorja ka dalë si ndryshim dhe plotësim i Rregullores për tatimin në pronë. Ka gabime në emërtim të rrugëve dhe të zonave.

Shemsi Veseli kërkoi sqarim nga ekzekutivi, se ka qenë apo nuk kanë qenë në diskutim publik kjo rregullore. Ne nuk kemi të drejtë ta shkelim Ligjin për vetëqeverisje e as Statutin. Nëse kjo rregullore nuk ka qenë në diskutim publik, atëherë kërkoj të qitet në diskutim publik.

Kryesuesi shprehu mendimin se kjo rregullore nuk ka qenë në diskutim publik.

Genc Sherifi propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të futet në proces të votimit.

Kryesuesi konstatoi se më 23 (njëzet e tri) vota për, 15 (pesëmbëdhjetë) vota kundër, (votimi është bërë me ngritje dore dhe nuk janë të regjistruar emrat e votuesve), pikat tre dhe pesë të rendit të ditës shtyhen për seancën e radhës, Propozimrregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tatim në pronën e paluajtshme dhe Shqyrtimi i raportit financiar tremujor për periudhën janar-qershor 2017.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 36 (tridhjetë e gjashtë) vota për, hynë si pikë e pestë e rendit të ditës: “Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim afatshkurtër Federatës së Tenisit të Kosovës”.

Kryesuesi konstatoi se u miratua ky

R E N D I D I T Ë S :

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;**
- 2. Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2018 dhe shqyrtimi Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2018-2020;**

3. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit të memorialit përkujtimor për ushtarët britanikë të KFOR-it;
4. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personave fizikë;
5. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim afatshkurtër Federatës së Tenisit të Kosovës;
6. Pyetje dhe përgjigje;
7. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Kryesuesi konstatoi se më 37 (tridhjetë e shtatë) vota për, u miratua procesverbali i mbledhjes së katërt të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Pika e dytë

Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2018 dhe shqyrtimi i Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2018-2020.

Ismail Kokaj theksoi se buxheti i Komunës së Prishtinës për vitin 2018, sipas qarkores së dytë buxhetore të Ministrisë së Financave, është 71,222,581 €. Tabelën buxhetore të gjithë e keni të bashkangjitur, gjithashtu edhe kornizën afatmesme buxhetore, dhe mund t'i shikoni ku janë të shpërndara planifikimet buxhetore. Nga ky buxhet për kategoritë "paga dhe mëditje" janë të ndara 29.2 milionë €, "mallra dhe shërbime" janë 13.4 milionë €, "komunali" janë 1.7 milion €, "subvencione dhe transfere" janë 1.8 milionë € dhe "investime kapitale" 24.9 milionë €.

Agim Gashi kërkoi sqarim nga ekzekutivi lidhur me planifikimin e të hyrave, ku është futur një burim i ri i të hyrave "menaxhimi i mbeturinave". A është fjala për arkëtimin e mjeteve nga qytetarët për shkak të shërbimit të kompanisë "Pastrimi"? Duke u bazuar në Ligjin për menaxhimin e mbeturinave, Komuna është përgjegjëse për arkëtimin dhe menaxhimin e atyre mjeteve.

Sa i përket shpërndarjes së buxhetit, ai tha se kam disa kërkesa, siç janë, investimet për futjen në sistem të ujërave të zeza në komunën e Prishtinës, ku janë tri projekte të mëdha në këtë fushë: Kolektori përbri ose nën rrugën "A", që do të thotë e përcjellë rruga "A" nga lagja "Matit 1", përkatësisht Zllatari, deri në Kalabri; kolektori nga Pallati i Drejtësisë deri në kufi me komunën e Graçanicës dhe vazhdimi i punës së kolektorit të lumit Prishtina dhe rrugës mbi të. Sa i përket lumit Mat, shprehu dyshime se si mund të ndërtohet rruga kur nuk është ndërtuar kolektori!

Njëherësh ai kërkoi të ndahet një sasi e vogël mjetesh për kolektorin nga Pallati i Drejtësisë në drejtim të lumit Graçanka. Ai u shpreh i rezervuar për miratimin e buxhetin pa e pasur një kod buxhetor për ndërtimin e objekteve shkollore në komunën e Prishtinës.

Sa i përket grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave inerte, është e rëndësishme të ceket se nuk ka destinacion ligjor për grumbullimin dhe deponimin e mbeturinave.

Ai preku edhe objektet me vlerë kulturore, ku çdo vit duhet të punohet në mbrojtjen dhe ruajtjen e tyre, për çka duhet të krijohet një kod sado i vogël, që ne ta ruajmë një kontinuitet dhe ta krijojmë një kulturë për mbrojtjen e vlerave tona.

Sa i përket bujqësisë, ai tha se bujqësia, sidomos zhvillimi rural i Prishtinës, nuk mund të paramendohet pa një buxhet stabil, që çdo vit të ketë një rritje sado të vogël për përkrahjen e bizneseve.

Hatixhe Hoxha theksoi se e kemi analizuar buxhetin për vitin 2018 dhe kemi konstatuar se është i shpjeguar mirë në tabela, varësisht prej drejtorive. Urojmë që në të ardhmen, nevojat dhe kërkesat e qytetarëve të jenë më të mëdha dhe ekzekutivi me korrektësi t'i zbatojë këto plane që i kanë bërë për vitin 2018.

Muhamet Selmani uroi që ky buxhet i planifikuar të realizohet, por nga parashikimet që i kemi dhe nga dëshmitë që vijnë nga vitet e kaluara, shihet se prapë do të kemi pengesa. Për çdo vit deri më tani janë planifikuar deri në 3.5 milionë € nga të hyrat, parkingu dhe ndërmarrja "Hortikultura", ndërsa për këtë vit këto të hyra janë zbritur në 535 mijë €.

Sa i përket legalizimit të ndërtimeve pa leje, ka hequr dorë për disa milionë €, pastaj te shpronësimet, pra ky buxhet nga të hyrat vetjake do të jetë prapë diku 4 ose 5 milion € më pak. Lidhur me buxhetin ai bëri edhe një mori vërejtjesh, të cilat janë dhënë të plota në transkript.

Sami Boroci tha se në parim do ta mbështesim buxhetin, por kam një kërkesë për ndërtimin e kolektorit nga Pallati i Drejtësisë në drejtim të Graçanicës. Kjo është nevojë urgjente e banorëve në lagjen "Prishtinës së Re". Kemi mungesë të Shtëpisë së kulturës dhe kjo është një kërkesë e kahershme e banorëve të kësaj lagjeje të Prishtinës, të cilët kanë kërkuar që një objekt i tillë të jetë në Hajvali. Ai u deklarua në mbështetje të buxhetit.

Rita Begolli theksoi se GP i AAK-së e përkrah miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2018 dhe Kornizën afatmesme buxhetore për vitin 2018-2020.

Fati Mehdiu, sa i përket mbrojtjes së objekteve kulturore historike, investimeve në bujqësi, pastaj rregullimit të lumit Mat, tha se këto janë çështje shumë të rëndësishme. Ai kërkoi të dijë se pse janë bashkë pagat dhe mëditjet dhe a ka mundësi të ndahen.

Abetare Fazliu u shpreh se, me të gjitha vërejtjet që u dhanë, shpresoj që do të ketë investime më të mëdha në shëndetësi dhe kulturë. LB-ja e përkrah dhe uron që të realizohet ky plan.

Nenad Miladinoviç tha se këtë buxhet e kemi shqyrtuar edhe në Komitetin për Komunitete dhe e përkrahim për miratim.

Misim Bajrami ceku se te tabela nr. 3, "planifikimi i shpenzimeve për Komunën e Prishtinës prej 2017-2020", janë me të njëjtën shumë, 1.793.000 €, ndërsa në raportin gjashtëmujor, në bashkësi lokale janë paraparë të investohen 700 mijë €, por kjo nuk është realizuar.

Vlora Dumoshi shprehu mendimin se ky buxhet duhet të rishikohet, sepse ka shumë probleme, shumë gabime. Ndoshta do të ishte mirë të kthehej prapa dhe të plotësohej me të gjitha kërkesat, pastaj të miratohej, sepse në këtë mënyrë është buxhet gjysmak.

Ajo tha se për mua është e papranueshme rënia e buxhetit në 1 milion, prej 2 milionë 735 mijë €. Kjo është dashur të rritet diku në 4 deri 5 milionë €, sepse është e nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve në kulturë, rini dhe sport.

Shefki Gashi tha se ky buxhet nuk i plotëson nevojat, andaj propozoj dhe e lus grupin tim që të votojë, që 500 mijë € të merren prej kodit të konsulencës dhe 200 mijë € prej infrastrukturës rurale dhe të hyjnë në furnizimin e parë të vijës së ujit, pra zgjerimin e rrjetit të ujit: Makoc, Grashticë, Mramur, Busi, Suteskë, Mukatë, Llajshëc, Slivovë.

Bardha Dida - Rogova shprehu mendimin se do të duhej të bëhej një aktivitet i shtuar në shkollat fillore të Prishtinës. Ajo tha se ky buxhet duhet të aprovohet kështu siç është ose të refuzohet, meqenëse është afati i fundit për dërgim të buxhetit.

Imer Rusinovci tha se ne si GP e përkrahim dhe e votojmë buxhetin, por kërkoj nga drejtorja përkatëse dhe të gjithë të pranishmit, që të më përkrahin në idenë që buxheti për Sektorin e bujqësisë në të ardhmen të jetë më i lartë. Buxhetin për bujqësi vazhdimisht do të duhej ta kishim në rritje, në mënyrë që ta ndalim importin e madh të produkteve bujqësore.

Ai kërkoi nga Kuvendi që ta mundësojë asfaltimin e rrugës Nishevc - Orllan, që është në gjatësi 2.6 - 2.8 km, e cila do të iu ndihmojmë atyre pak fermerëve që kanë mbetur atje, të cilët të vetmin burim ekzistencial e kanë prodhimtarinë bujqësore.

Shaip Hajrizi ceku se lagjja "Kodra e Trimave", apo më konkretisht te shkolla "Hilmi Rakovica" dhe te "Bunari i Hajratit", shpeshherë kanë mungesë të ujit, më shumë orë nuk kanë ujë sesa që kanë. Edhe në lagjet tjera ka mungesë të ujit dhe ne vazhdimisht e bëjmë atë propagandën që Prishtina ka ujë 24 orë. Shpresojmë që ky problem të zgjidhet sa më shpejt.

Lirie Avdiu, lidhur me buxhetin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, te ndërtimi i rrugëve në pjesën rurale, në vitet paraprake, në planifikimet buxhetore janë propozuar disa rrugë dhe asnjëherë nuk është ndërmarrë diçka për ndërtimin e atyre rrugëve. Ndërsa sa i përket Drejtorisë së Mirëqenies Sociale dhe Shëndetësisë, propozoj që të jetë një linjë e veçantë buxhetore, me anë të së cilës do të afrohej shërbim mjekësor për të gjitha kategoritë e banorëve të pjesës rurale.

Sylejman Pireva ceku se për këtë pikë të rendit të ditës është menduar që do të ketë vërejtje, plotësime dhe sugjerime, por jemi këtu që të diskutojmë dhe t'i plotësojmë ato në mënyrën më të mirë të mundshme.

Hatixhe Latifi - Pupovci, sa i përket buxhetit, ajo paraqiti një kërkesë, që kishte të bënte me paraqitjen e të gjitha rrugëve që planifikohen të ndërtohen me këtë buxhet në ueb-faqen e Komunës së Prishtinës.

Ajnishahe Azemi lidhur me emërtimin e Qendrës, nga Qendra për qëndrim ditor për persona me nevoja të veçanta në ndërtimin e Qendrës për persona me nevoja të veçanta (Sindrom Down dhe Autizëm), tha se është kërkuar kthimi i emërtimit dhe të bëhet ndërtimi i Qendrës për qëndrim ditor për persona me nevoja të veçanta, që duhet të jetë për të gjithë, pa u specifikuar asnjë kategori. Kryetari ka potencuar se nuk ka nevojë të jetë në kllapa (Sindrom Down dhe Autizëm) pra të hiqet dhe ta ndërtojmë Qendrën për persona me nevoja të veçanta. Por ky premtim i dhënë ende nuk është realizuar.

Shemsi Veseli theksoi se ky buxhet vetëm duhet të miratohet si formalitet, duke cekur se fare nuk po pyetet as mendimi i këshilltarëve që e prezantojnë interesin e shumë qytetarëve. Ai dha shumë vërejtje rreth këtij materiali, dhe është punuar për t'i vendosur shumë objektiva, por nuk iu kanë përmbajtur shumë gjërave që i parasheh ligji. Projektbuxheti duhet të përmbajë misionin, objektivat e projekteve që e promovojnë zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm, ky është synimi që duhet ta ketë sa i përket projektbuxhetit; ndërsa sa i përket kornizës afatmesme buxhetore, gjegjësisht qarkores, është bërë shkelje ligjore, për këtë ka folur edhe IMP-o që e përcjellë punën e Kuvendit.

Mustafë Krasniqi shprehu mendimin se buxheti duhet të rishikohet, në mënyrë që të ndahen mjete, të planifikohet pjesa e unazës së jashtme të qytetit, si dhe të bëhet zgjerimi i rrugës nga

Bunari i Hajratit deri te lagjja "Ugrija". Kjo është e domosdoshme dhe është mirë që të parashihet për vitin që vjen, ose deri në vitin 2020.

Sadri Ramabaja tha se ky buxhet është i kufizuar, dëshirat janë të mëdha, por mundësit janë jashtëzakonisht të vogla që të gjitha këto propozime, gati pa përjashtim, duke filluar prej atyre që i thanë parafolësit, janë kërkesa dhe nevojë.

Naime Osmani kërkoi që në këtë projektbuxhet për vitin 2018, të përfshihet ndërtimi i rrugës Rimanishtë - Lagja e Mramorëve, që i lidhë fshatrat Sharban, Rimanishtë, Siqevë, si dhe disa rrugica në Besi. Gjithashtu kërkoi të parashihet rrethimi i varrezave në Vranidoll, që është bërë një ndarje, dhe ndriçimi në lagjen "Balaj" në Rimanishtë.

Genc Bashota theksoi se të gjitha këto kërkesa që ju i propozuat, të cilat arrijnë vlerën rreth 10 milionë €, është e pamundshme t'iu japim përgjigje. Ne e kemi bërë buxhetin me krejt vijat buxhetore dhe i rrimë karshi propozimit që sot e kemi sjellë në Kuvend dhe presim që të miratohet apo të refuzohet.

Berat Lahu u shpreh se ideja është që sot t'i trajtojmë çështjet që ishin paraparë sipas rendit të ditës dhe t'i kalojmë ato për të cilat mendojmë që do të kalojnë, por varësisht prej votës.

Sa i përket buxhetit, për shkak të rëndësisë së tij, duhet të trajtohet më seriozisht, në mënyrë që të jepet vota ashtu siç e mendon secili asamblist.

Hetem Kupina theksoi se ky projektbuxhet është debatuar me qytetarë, janë ftuar kryetarët e bashkësive lokale, të cilët janë alfa dhe omega e pushtetit lokal, të cilët kanë marrë pjesë në diskutim dhe i kanë dhënë propozimet e tyre.

Arben Vitia, drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë, lidhur me vërejtjet e dhëna për këtë pikë të rendit të ditës dha sqarime të nevojshme, diskutimin e të cilit mund ta gjeni të plotë në transkript.

Besart Vllahinja, drejtor i Drejtorisë së Kulturës, ceku se nga qershori i këtij viti e kemi Rregulloren e re, e cila parasheh kritere të reja, të cilat do të përkufizojnë dhe do të përmirësojnë aspektin e ndarjes së mjeteve dhe subvencioneve për këto kategori buxhetore. Ai shtoi se në këtë fazë është edhe kategoria e furnizimit me libra, që këtë vit jemi në përfundim të procesit të furnizimit.

Ardian Olluri lidhur me propozimet e bëra, theksoi se është e pamundur me i analizuar, pra mund të bëhet ndonjë gabim dhe pastaj buxheti i miratuar na del i paligjshëm.

Ai propozoi që të votohet buxheti si i tillë, pastaj çdo ndryshim mund të analizohet në rishikimin e buxhetit.

Agim Gashi paraqiti një kërkesë për kryesuesin, që para se të votohet buxheti, të qiten në rend të ditës për votim propozimet që u dhanë nga këshilltarët.

Ai u shpreh se propozimi im është që për kanalizimin në Hajvali, prapa Pallatit të Drejtësisë, të parashihet një shumë në kuadër të ndërtimit të rrugëve në pjesët urbane dhe infrastrukturës përcjellëse 300 - 400 mijë € nga ky pozicion buxhetor 2 milionë e 200 mijë €, dhe të merren 500 mijë € nga pozicioni për ndërtimin e parqeve. Për Ujësjellësin në relacionin Grashticë - Slivovë të merren 500 mijë € nga ndërtimi i rrugëve në pjesët rurale në infrastrukturë përcjellëse.

Muhamet Selmani paraqiti propozime konkrete për disa projekte. Propozimin e dhëne nga Imer Rusinovci, i cili e përmendi rrugën Nishevc - Orllan, me gjatësi 2.8 kilometra, kërkoi që mjetet të merren nga kodi buxhetor te Drejtoria e Infrastrukturës, në pikën 1.4.2.1 - ndërtimi i rrugëve në pjesën rurale me infrastrukturë përcjellëse, dhe të hyjë ky si projekt prioritar.

Sa i përket urës dhe zgjerimit të shtratit të lumit në Lagjen e Vërbovcëve, të hyjë prapë në këtë pikë, si dhe ura tjetër në dalje të fshatit Barilevë të futet si pikë e rendit të ditës. Po ashtu, pika 1.4.2.2 - ndërtimi i rrugëve në pjesët urbane me infrastrukturë përcjellëse, të futet projekti për ndërtimin e mbikalimit që e lidh lagjen "Lakërishta" me lagjen "Dardania".

Laura Zherka kërkoi shpjegim për projektet që i ka Komuna, për të cilat do të investojë brenda kësaj kategorie, pa marrë parasysh a hyjnë propozimet tjera.

Sa i përket kanalizimit në Hajvali, tha se është prioritet, sepse jemi duke e filluar ndërtimin për lagjen "Kodrina".

Mirlinda Sopi kërkoi që të jepet fund me diskutime dhe të procedohet me votimin e projektbuxhetit.

Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Pronës, tha se në fillim të seancës është votuar rendi i ditës, ku për secilën pikë të rendit të ditës ka hapësirë për me diskutuar dhe në fund ai propozim vihet në votim. Është e pakuptimtë t'i pranojmë propozimet të cilat objektivisht i kemi të pamundshme t'i përfshijmë.

Berat Lahu tha se kjo mbledhje është duke u sabotuar qëllimisht nga kryesuesi dhe grupi i asamblistëve të PDK-së dhe LDK-së, të cilët kanë qenë bashkë gjatë këtyre katër vjetëve.

Hatixhe Hoxha kërkoi debat për secilën pikë të propozuar.

Genc Sherifi kërkoi sqarim për propozimin e z. Agim Gashi, se si do ta bëjë atë projekt, si e ka analizuar dhe si do të realizohet.

Kryesuesi konstatoi se më 27 (njëzet e shtatë) vota për, u miratua propozimi që të hyjë në buxhet projekti për rregullimin e kanalizimit në Hajvali, prapa Pallatit të Drejtësisë.

Kërkesa e dytë është ujësjellësi Grashticë - Slivovë.

Agim Gashi tha se ky është propozimi im, të merren 500 mijë euro nga ky pozicion dhe 500 mijë nga pozicioni i rrugëve urbane dhe të bëhen 1 milion €.

Ismail Kokaj bëri të ditur se ekzistojnë vijat buxhetore ku mund të futen këto, për atë arsye edhe ju kam thirrur për ta votuar buxhetin, e që më vonë mund ta diskutojmë edhe në rishikimin e buxhetit, apo edhe tash jemi në prag të zgjedhjeve dhe ndoshta dikush tjetër mundet komplet me e ndërruar.

Berat Lahu theksoi se buxheti duhet të qitet në votim, por të shkojë si rekomandim që në rishikimin e buxhetit këto projekte, këto propozime të merren me prioritet.

Kryesuesi i ceku disa projekte më madhore, si ujësjellësi Grashticë - Slivovë, me infrastrukturë përcjellëse, rruga Nishevc - Kushevicë, që kapet me Orllan, ura te Lagjja e Vërbovcëve, ura në Barilevë dhe disa projekte të tjera me rëndësi.

Kryesuesi konstatoi se më 28 (njëzet e tetë) vota për dhe 3 (tri) abstenime, (votimi është bërë me ngritje dore dhe nuk janë të regjistruar emrat e votuesve) u miratua Vendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2018 dhe shqyrtimi i Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2018-2020, ashtu si është me rekomandim që projektet e lartpërmendura të hyjnë në rishikim të buxhetit.

Pika e tretë

Propozimvendimi për caktimin e lokacionit të memorialit përkujtimor për ushtarët britanikë të KFOR-it.

Kryesuesi konstatoi se më 29 (njëzet e nëntë) vota për, u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit të memorialit përkujtimor për ushtarët britanikë të KFOR-it.

Pika e katërt

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personave fizikë.

Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Pronës, ceku se janë tri raste të këmbimit të pronës së paluajtshme, të parin e kemi me propozim të Drejtorisë së Investimeve Kapitale, për shkak të devijimit të rrugës, ndërsa dy të tjerat i kemi në saje të zgjidhjeve urbane që i kemi pranuar prej Drejtorisë së Urbanizmit.

Shemsi Veseli kërkoi sqarim se pse është vonuar ky vendim prej vitit 2012.

Kryesuesi konstatoi se më 29 (njëzet e nëntë) vota për, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të ENK "Invest Group" SHA.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri më 29 vota për, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të pronares Shpresa (Sejdi) Etemi.

Kryesuesi konstatoi se më 29 vota për, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarit Mentor Vitija.

Pika e pestë

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim afatshkurtër Federatës së Tenisit të Kosovës, pa procedurë konkurrimi.

Agim Gashi tha se në Komitetin për Politikë dhe Financa kemi propozuar që të ndryshohet pika për Hortikulturën. Është thënë se pa procedurë konkurrimi, nuk kemi të drejtë dhënien e pronës në shfrytëzim afatshkurtër, andaj kërkoj që lëndët e natyrës së njëjtë të mos trajtohen në mënyra të ndryshme. Nëse kemi të drejtë jemi për, por nëse jo, atëherë përmirësojeni edhe propozimvendimin e Hortikulturës e të bëhet në periudhë afatshkurtër.

Fatos Dibra tha se ishte procedurë e veçantë, andaj mundet me u dhënë edhe afatgjatë.

Ardian Olluri bëri të ditur se kanë marrë një shkresë nga MAPL-ja që për rastet e dhënies në shfrytëzim me procedurë të veçantë nuk vlen kufizimi në gjashtë muajt e fundit.

Insistimi juaj ishte se nuk mundemi me dhënë afatgjatë, për shkak se kjo nuk është me procedurë të veçantë dhe shpjegimi i z. Dibra ishte që nëse nuk është procedurë e veçantë,

atëherë pse po e bëjmë procedurë e veçantë, sepse atëherë duhet me e qitur në ankand. d.m.th. nëse nuk qitet në procedurë konkurruese, është dhënie me procedurë të veçantë.

Muhamet Selmani kërkoi sqarim lidhur me parcelën, se a është e tërë apo është e ndarë ndonjë pjesë e veçantë qe jepet për tenis.

Kryesuesi tha se do të ishte mirë që kjo pjesë me qenë e parcelizuar, pra nuk qenka e parcelizuar.

Dren Kukaj tha se sa i përket lokacioneve të mira në qendër për nevoja të sportit, është vështir me i gjetur, sepse nuk kemi hapësira të mjaftueshme.

Nuk jam i mendimit që të gjitha me i quar në periferi, por gjithsecilën fushë sportive që ka financa me e implementuar.

Mustafë Krasniqi shprehu mendimin që të jepen në shfrytëzim edhe ato dy fusha dhe hapësirën përreth, që të krijojnë edhe pjesë tjetër të infrastrukturës për zhvillimin e sportit. Hapësira ku është menduar me u ndarë, mendoj se e bën një shkëputje komplet të lagjes. Meqenëse nuk kemi projekt, ne vetëm i kemi dyshimet tona.

Kryesuesi konstatoj se më 28 (njëzet e tetë) vota për, 4 (katër) abstenime (votimi është bërë me ngritje dore dhe nuk janë të regjistruar emrat e votuesve) u miratua Vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim afatshkurtër Federatës së Tenisit të Kosovës, pa procedurë konkurrimi.

**Pika e gjashtë dhe e shtatë
Pyetje, përgjigje dhe të ndryshme.**

Shaip Hajrizi, pyetje për z. Muhedin Nushi, nënkryetar i Komunës dhe u.d. i drejtorit të Drejtorisë së Administratës.

Tani jemi në muajin e dhjetë, është mbledhja e pestë, d.m.th. këtë vit i kemi pesë mbledhje mangu, që d.m.th. për katër vjet besoj që diku nja 20 mbledhje i kemi pasur mangu.

Për çdonjërin 20 mbledhje nga 200 €, ku kanë shkuar ato para, kur e dimë që buxheti është i planifikuar, i rezervuar për 12 mbledhje në vit?

A ka dhënë dikush ndonjë raport nëse nuk i mbajmë 12 mbledhje ku shkojnë ato para, unë këtë kurrë nuk e kam dëgjuar. Faktikisht pesë mbledhje i kemi e tani është muaji i dhjetë.

Bardha Dida - Rogova, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Pronës.

Unë do e bëj një pyetje dhe kërkoi që drejtori të më përgjigjet me shkrim.

Shihet se në investimet kapitale për tri vitet e ardhshme nuk është paraparë ndërtimi i Shkollës së Muzikës. Pra, kur planifikohet të ndërtohet Shkolla e Muzikës?

Më duket se me këtë pyetje edhe kam filluar mandatin edhe me këtë po e përfundoj!

Sylejman Pireva, pyetje për u.d. të drejtorit të Drejtorisë së Administratës.

Një pyetje e thjeshtë, pasi janë edhe disa prej drejtorëve këtu.

A do të ndërtohet një shtëpizë për rojtarët e oborrit të Komunës, apo do të mbeten ende në të ftohët dhe në të nxehtë në atë qoshk aty, i cili është i padurueshëm në temperatura minimale dhe maksimale?

Mbledhja përfundoi në orën 15:20.

**Procesmbajtësja
Luljeta Selimi**

**Kryesuesi i kuvendit
Halim Halimi jur. i dipl.**